



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJIA ADMINISTRATIVE BATHORE

N^r 213/P
rot

Bathore, me 10. 11. 2025

RELACION

“Mbi emertimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në
juridiksionin e Bashkisë Kamëz”

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për detyrat tuaja funksionale që realizoni pranë këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi emertimin e rrugëve në Lagjen Administrative Bathore, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 “Për sisemin e adresave”; Vendimit nr.226 prot 27.03.2023 për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz si dhe referuar kërkesave me shkrim të banorëve të lagjeve të ndryshme Bathore, të depozituara pranë Lagjes administrative Bathore për emertimin e këtyre e rrugëve.

Në Bazë të verifikimeve në terren nga grupi punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i kësaj lagjeje dhe ju propozojmë ju në cilësinë e organit legjislativ të bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për emertimin rrugës të cituar si më poshtë:

-Emertimin e rruges, ngjitur me rrugen “ Zadrime “ dhe rrugen “Synej”, Lagje nr 4, ku propozohet ti vendoset emri “Bruz”.

Të gjithë banoret e kësaj rruge e kanë origjinën nga Fshati Bruz/Krujë. Ky emer për këta qytetar nuk është thjeshtë një sugjerim por përfaqëson identitetin e tyre kulturor dhe trashgiminë historike të kesaj zone.

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesat me shkrim për emertimet e rrugëve dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qëllim realizimin e kërkesës së qytetarëve

Për sa më lartë :

PROPOZOJMË

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për emertime të rrugëve , me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtuara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret e parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

Komisioni i Posaçëm:

-Besim Rama

Firma

-Qemal Meçuku

Firma

-Selman Billa

Firma





Kërkesë për Caktimin e Emrit "Ruga Bruzi"

Ne; Z. Rakip Suli, Kryetar të Bashkisë Kamëz

Adresa; Bulevardi 'Nene Tereza' Nr402 Kamez, Tirane

Dhe

Z. Afrim Doci Administrator i Njesis Administrative Bathore

Adresa: Ruga Demokracia Bathore Kamez

Data: 06.10.2025

Subjekti: Kërkesë për caktimin e emrit "Ruga Bruzi" për rrugën pa emër në Lagjen 4, pranë rrugës "Zadrima".

I nderuar Z. Kryetar Suli,

Me nderim dhe respekt, ju drejtohem në emër të të gjithë banorëve të rrugës sonë aktualisht pa emër në Lagjen 4, Bathore.

Ruga jonë ndodhet në zonën e rrugës "Zadrima", në afërsi të rrugës "Synej". Sot, ajo nuk ka një emër zyrtar, gjë që na shkakton vështirësi të mëdha në jetën e përditshme, duke penguar:

- **Pranimin e postimeve, dërgesave dhe shërbimeve.**
- **Regjistrimin e saktë të adresës në dokumente personale.**
- **Gjetjen e shpejtë nga shërbimet e urgjencës (si ambulanca, policia) dhe nga vizitorët.**

Arsyeja kryesore e propozimit tonë:

Ne, të gjithë banorët e kësaj rruge, vijmë historikisht nga toka dhe zona që quhet "Bruz". Ky emër nuk është thjesht një sugjerim, por përfaqëson identitetin tonë vendor dhe trashëgiminë historike të kësaj zone. Duke e emëruar rrugën tonë "Bruz", ne jo vetëm që i zgjidhim problemet administrative, por edhe perpetuajmë dhe nderojmë një pjesë të rëndësishme të historisë sonë lokale, duke e ruajtur këtë emër të vyer për brezat e ardhshëm.

Për të vërtetuar vullnetin tonë të përbashkët, në aneks të kësaj shkrese kemi bashkuar nënshkrimet e të gjithë banorëve të kësaj rruge, të cilët janë njëzëri në mbështetje të këtij propozimi.

Shpresojmë që kërkesa jonë, e bazuar në një argument kaq të fortë historik dhe kulturor, të gjejë mirëkuptim dhe mbështetje nga ana juaj. Jemi të gatshëm për çdo formë bashkëpunimi për të çuar këtë proces deri në fund.

Me respekt të thellë,

Banorët e Rrugës së Papërcaktuar

Lagjia 4, Pranë Rrugës "Zadrima", Bathore

LISTA E NËNSHKRIMEVE TË BANO
RËVE

1 Shkelqim Baftaj

2 Albert Baftaj

3 Selime Baftaj

4 Flamur Metaj

5 Arben M

6 Zoje Metaj

7 Fatmir Allushi

8 Petrit Isaku

9 Andi Isaku

10 Astrit Isaku

11 Shpetim Isaku

12 Naile Isaku

13 Besim Isaku

14 Kurt Hida

15 Agron Hid

a